



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 19412 Prot

Shkodër, më 11. 11 .2019

Lënda: Kërkesë për dhënie mendimesh për Buxhetin e vitit 2020 dhe Projekt Buxhetin Afatmesëm 2020-2022.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, ligjin nr.68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”, nr.7 datë 27.02.2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2020-2022” nr. 20 date 10.07.2019 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, administrata e Bashkisë Shkodër ka paraqitur në këshill projektin e parë të PBA 2020-2022. Me shkresën nr 11597, datë 18.06.2019, me protokoll hyres të Bashkise Shkoder nr. 10960 date 26.06.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka përcjellë mendimet në lidhje me hartimin e PBA 2020-2022.

Pas përfundimit të konsultimeve publike me banorët dhe përfaqësuesit e biznesit, takime ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë, administrata e bashkisë është duke punuar për hartimin e buxhetit të vitit 2020, duke reflektuar kërkesat dhe sugjerimet sipas konsultimeve publike dhe mendimeve të dhëna nga MFE. Kërkojmë nga ana e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Shkodër sugjerimet dhe propozimet tuaja

Bashkëlidhë në version elektronik gjeni

Draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2020-2022 të Bashkisë Shkodër (matrica). sipas funksioneve, programeve buxhetore me qëllime, objektiva, tregues dhe me aktivitete paraprake, në kuadrin e objektivave strategjik të miratuar me Planin e Përgjithshëm Vendor, e cila është e publikuar edhe në faqen e bashkise tek

http://ëëë.bashkiashkoder.gov.al/ëëb/Njoftim_per_keshillim_me publikun_Per_draftin_e_projekt_tplanit_buxhetor_afatmesem_2020_2022_dhe_ndryshimeve_ne_paketen_fiskale_te_Bashkise_14_76_1.php

Vemë në vemendjen tuaj që këto propozime duhet të jenë brenda kuadrit ligjor të aplikueshëm.

Mbetemi në pritje të propozimeve tuaja deri më datë 21 nëntor 2017, në mënyrë që të kemi mundësi për vlerësimin e tyre nga ana teknike dhe për reflektim të tyre.

Duke ju falenderuar për angazhimin tuaj.

KRYETAR


Voltana Ademi

